



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 13 shkurt 2015
Nr. ref.:RK 772/15

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI162/14

Parashtrues

Shefki Hyseni

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, kryetar
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është z. Shefki Hyseni, me vendbanim të përhershëm në Mitrovicë.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi e konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme).

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014, me të cilin parashtruesi pretendon se i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

Baza juridike

4. Neni 113.7 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), neni 22 dhe 47 i Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 30 tetor 2014, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 6 nëntor 2014, Kryetari i Gjykatës, me Vendimin nr. GJR. KI162/14, caktoi gjyqtarin Robert Carolan gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, Kryetari, me Vendimin nr. KSH. KI162/14, caktoi Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi.
7. Më 6 nëntor 2014, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga i njëjti plotësimin e kërkesës me dokumentacion relevant. Të njëjtën ditë është informuar edhe Gjykata Supreme, të cilës i është dërguar një kopje e kërkesës.
8. Më 8 dhjetor 2014, parashtruesi dorëzoi formularin e kërkesës të plotësuar dhe këtij formulari ia ka bashkëngjitur Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014.
9. Më 22 janar 2015, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

10. Më 18 mars 2009, Gjykata Komunale në Ferizaj (Aktgjykimi, P. nr. 798/2006), shpalli fajtor parashtruesin e kërkesës për veprën penale të mashtrimit nga nenin 261, paragrafi 1 i Kodit Penal të Kosovës (KPK), duke i shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej 20 (njëzetë) muajve.
11. Më 23 tetor 2012, Gjykata e Qarkut në Prishtinë (Aktgjykimi, Ac. nr. 285/2009) ndryshoi aktgjykimin e Gjykatës Komunale të Ferizajt, përkitazi me masën e

dënimit të parashtruesit, duke ia ulur dënimin me burg nga 20 (njëzetë) muaj, në 1 (një) vit.

12. Më 20 korrik 2014, parashtruesi në Gjykatën Supreme parashtroi kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë, duke pretenduar shkelje esenciale të dispozitave të ligjit të procedurës penale.
13. Më 27 gusht 2014, Gjykata Supreme (Aktvendimi Pml. nr. 165/14) hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, për shkak se, sipas gjykatës në fjalë nuk ishin përmbushur kriteret procedurale të lejueshmërisë, të përcaktuara me ligjin në fuqi.
14. Për më tepër, Gjykata Supreme arsyetoi:

[...]

“Nga përmbajtja e kërkesës për mbrojtjen e ligjshmërisë nuk rezulton se me këtë mjet juridik është atakuar ndonjë vendim i gjykatës sepse në të nuk precizohet se cili vendim është atakuar apo procedura gjyqësore e cila i ka paraprirë marrjes së vendimit të tillë.

Përkundrazi, në kërkesë potencohet vetëm fakti se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit dhe kështu është shkelur ligji meqë nuk i është mundësuar ushtrimi i mjetit juridik kundër vendimit të gjykatës së shkallës së dytë.

Qëndron fakti se në rastin konkret aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk i është dorëzuar të dënuarit meqë siç rezulton nga shkresat e çështjes - fletëkthesa, me datë 4. 3. 2013 është tentuar dorëzimi i shkresës të dënuarit mirëpo në fletëkthesë është konstatuar se pala është e panjohur. Megjithatë Gjykata Supreme vlerëson se në rastin konkret kërkesa e të dënuarit për mbrojtjen e ligjshmërisë është e parakohshme sepse në një situatë të tillë i dënuari do të duhej t'i drejtohej gjykatës së shkallës së parë me kërkesë që t'i dorëzohet në mënyrë të rregullt aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nga e cila ditë fillon të ecë afati e më pas duke respektuar afatin ligjor të ushtrohet ky mjet juridik”.

[...]

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

15. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme ka shkelur të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutë, për faktin se gjykata në fjalë hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesën për mbrojtje të ligjshmërisë, sepse sipas parashtruesit gjykata në fjalë nuk mori parasysh faktin se atij nuk i është dorëzuar Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, Ac. nr. 285/2009, i 23 tetorit 2012.

Pranueshmëria e kërkesës

16. Gjykata së pari vlerëson nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të parapara me Kushtetutë, dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
17. Në rastin konkret, Gjykata i referohet nenit 113.7, që përcakton:

“Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

18. Përveç kësaj, neni 47. 2 i Ligjit gjithashtu përcakton:

“Individi mund ta ngre kërkesën në fjalë vetëm pasi që të ketë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

19. Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 36 (1) b) të Rregullores së punës, që përcakton:

1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

(b) janë shteruar të gjitha mjetet juridike efektive të përcaktuara me Ligj kundër vendimit ose kundër aktgjykimit të kundërshtuar, ose

[...]

20. Nga shkresat e lëndës, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës konteston Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Pml. nr. 165/14, të 27 gushtit 2014, përkitazi me shkeljet e pretenduara të të drejtave të garantuara me Kushtetutë. Në fakt, parashtruesi nuk ka specifikuar se cila dispozitë konkrete e Kushtetutës i është cenuar. Megjithatë, Gjykata *inter alia* ka kuptuar që bëhet fjalë për të drejtat që derivojnë nga neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së, siç është e drejta për të poseduar vendimin e gjykatës, në mënyrë që palës a palëve t’iu jepet mundësia të kontestojnë një vendim gjyqësor të pafavorshëm dhe të përgatisin mbrojtjen e duhur, për ushtrimin e mjeteve juridike në gjykatat e instancës më të lartë.
21. Megjithatë, në këtë rast është e qartë, se parashtruesit i është dhënë mundësia nga Gjykata Supreme që aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës ta kërkojë dhe ta pranojë nga Gjykata Themelore në Prishtinë, dhe pasi ta ketë pranuar, ka mundur të llogarisë afatin ligjor për të parashtruar kërkesën për Mbrojtje të Ligjshmërisë. Nuk ka asnjë provë që tregon se parashtruesi i kërkesës, kishte kërkuar t’i dorëzohej aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Prishtinë.
22. Në rastin konkret, Gjykata nuk mund të konstatojë që, për shkak se parashtruesi i kërkesës nuk e ka kërkuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë dhe rrjedhimisht, me sa duket, nuk e ka pranuar aktgjykimin e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës, atij i është mohuar e drejta e ushtrimit të mjetit juridik kundër këtij aktgjykimi apo që i janë shkelur të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
23. Edhe nga arsyetimi i aktvendimit të Gjykatës Supreme vërehet qartë që kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë është hedhur poshtë si e palejuar, për shkak se është konsideruar e parakohshme. Gjykata në fjalë e ka këshilluar parashtruesin që t’i drejtohet Gjykatës Themelore në Prishtinë, për ta kërkuar Aktgjykimin Ac. nr. 285/2009, të 23 tetorit 2014, ku pas posedimit të të cilit do fillonte llogaritja e afatit ligjor dhe mundësia e ushtrimit të mjetit juridik në instancë më të lartë.

24. Prandaj, në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, ashtu siç kërkohet me nenin 113.7 të Kushtetutës, për faktin së ai ka dështuar të provoj se i ka shfrytëzuar mundësitë e dhëna nga Gjykata Supreme.
25. Gjykata rithekson se parimi i subsidiaritetit kërkon që parashtruesi të shterojë të gjitha mundësitë procedurale në procedurë të rregullt, në mënyrë që të parandalohet shkelja e Kushtetutës, apo nëse ka shkelje, të korrigjohet shkelja e tillë e të drejtave themelore. Ndryshe, parashtruesi i kërkesës është përgjegjës kur rasti i tij shpallet i papranueshëm nga Gjykata Kushtetuese, nëse ai ose ajo dështon të shfrytëzojë procedurat e rregullta, apo nëse dështon të raportojë shkeljet e Kushtetutës në procedurë të rregullt. Rregulli bazohet në supozimin se rendi juridik i Republikës së Kosovës siguron mjete efektive juridike për mbrojtje kundër shkeljeve të të drejtave kushtetuese (Shih Aktvendimin për papranueshmëri KI41/09, të 21 janarit 2010, *AAB-RIINVEST L.L.C. Prishtinë kundër Qeverisë së Republikës së Kosovës*, dhe shih, *mutatis mutandis*, ECHR, *Selmouni vs. Francë*, no. 25 803/94, Vendimi i 28 korrikut 1999).
26. Nga arsyet e cekura më lart, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret procedurale për pranueshmëri, të përcaktuara me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 47.2 të Ligjit dhe rregullin 36 (1) b) të Rregullores, për shkak të mosshterimit të mjeteve juridike.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, me nenin 47.2 të Ligjit dhe me rregullin 36 (1) b), si dhe me rregullin 56 (2) të Rregullores së punës, më 22 janar 2015, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


Gjyqtari raportues



Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese



Prof. dr. Enver Hasani